



Muhamet MAVRAJ



BIZNESET BLOKUAN PËR DY ORË HYRJET E PRISHTINËS KUNDËR LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË

FAQE 4-5



Përfaqësues të bizneseve kanë bllokuar të enjten hyrjet në kryeqytetin e Kosovës, në shenjë proteste për liberalizimin e tregut të energjisë, që do të nisë më 1 qershor. Vendimi i rregullatorit të energjisë

përfshin kompanitë me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro. Në Kosovë janë të regjistruara mbi 1 000 kompani të tilla që konsumojnë rreth 37 % të energjisë së përgjithshme të

shpenzuar. Përfaqësuesit e bizneseve thonë se janë kundër liberalizimit të tregut të energjisë, pasi nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për këtë ndryshim. Ata kërkojnë që ky vendim të shtyhet për një vit

KUVENDI NUK KONSTITUOHET AS PAS TENTIMIT TË 23-të

F. 3



DY VJET NGA DHUNA NË ZVEÇAN, MË SHUMË SE 90 USHTARË TË KFOR-it ISHIN LËNDUAR

F. 7



SPORT



PRISHTINA DHE DRITA VAZHDOJNË ME RISI, DUKAÇJINI 'BLINDON' MUNISHIN

F. 10

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVIÇE

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Elon Musku largohet nga administrata e Trumpit

WASHINGTON, 29 MAJ - Elon Musku po largohet nga roli i tij qeveritar si këshilltar i lartë i presidentit Donald Trump, pasi udhëhoqi përpjekjet për të shkurtuar dhe reformuar burokracinë federale, raporton AP. Largimi i tij, i njoftuar të mërkurën në mbrëmje, shënon fundin e një kapitulli që përfshiu mijëra largime nga puna, shuarjen e agjencive qeveritare dhe një sërë padish. Ai uli ndjeshëm objektivin për shkurtime në shpenzime, fillimisht nga 2 trilionë dollarë në 1 trilion, e më pas në 150 miliardë dollarë. Herë pas here, i përplasej me zyrtarë të tjerë të administratës Trump, të cilët e konsideronin të padëshiruar përpjekjen e tij për t'i ndryshuar strukturat e departamenteve të tyre.

Roli i Muskut në administratë ishte që në fillim i përkohshëm, dhe ai së fundi kishte dhënë sinjale se do të rikthehej te drejtimi i bizneseve të tij, si prodhuesi i makinave elektrike "Tesla" dhe kompania hapësinore "SpaceX". Megjithatë, zyrtarët e administratës nuk kishin qenë të qartë për momentin e saktë kur Musku do të largohej nga drejtimi i Departamentit për Efikasitet Qeveritar, i njohur si DOGE. Ai e njoftoi papritur largimin me një postim në rrjetin social X. "Me përfundimin e afatit tim të planifikuar si punonjës i posaçëm i qeverisë, dua ta falënderoj presidentin [Trump] për mundësinë që më dha për t'i shkurtuar shpenzimet e kota", shkroi ai. "Misioni i [DOGE] do të forcohet gjithnjë e



më shumë, duke u bërë pjesë e kulturës institucionale në të gjithë qeverinë". Njoftimi vjen një ditë pasi CBS publikoi pjesë të një interviste në të cilën Musku kritikonte ligjin kryesor të agjendës së Trumpit, duke thënë se ishte "i zhgënjyer"

me atë që presidenti e quante "projektligji i madh e i bukur". Ligji përfshin një kombinim të uljes së taksave dhe forcimit të kontrollit të emigracionit. Musku e quajti atë "projektligj shpenzimesh masive", që rrit deficitin federal dhe "minon

punën" e Departamentit të tij për Efikasitet. Trumpi, duke folur në Zyrën Ovale të mërkurën, e mbrojt agjendën e tij, duke theksuar politikën delikate të negociatave legislative. "Nuk jam i kënaqur me disa pjesë, por jam i entuziazmuar me të tjera", tha ai, duke shtuar se "do të shohim si do të shkojë - ka ende rrugë përpara". Projektligji kaloi në Dhomën e Përfaqësuesve dhe po shqyrtohet në Senat. Mandati 130-ditor i Elon Muskut si punonjës i posaçëm i qeverisë në administratën Trump pritej të përfundonte rreth datës 30 maj. Administrata ka deklaruar se përpjekjet e DOGE-s për ta ristrukturuar dhe zvogëluar qeverinë federale do të vazhdojnë.

Gjermania vendos kufizime për bashkimet familjare dhe ashpërsion rregullat për shtetësinë

BERLIN, 29 MAJ - Qeveria gjermane më 28 maj u pajtua për planet për të vendosur kufizime ndaj bashkimeve familjare për disa migrantë dhe për t'i ashpërsuar rregullat për marrjen e shtetësisë. Ashpërsimi i politikave të migracionit ishte premtimi kyç i kancelarit të ri konservator, Friedrich Merzh, gjatë fushatës për zgjedhjet e shkurtit dhe qeveria e tij menjëherë ka vendosur kontrolle në kufijtë e Gjermanisë pasi ai mori detyrën e kancelarit më herët gjatë këtij muaji. Ministri i Brendshëm, Alexander Dobrindt, u tha gazetarëve të mërkurën se masat e reja janë të rëndësishme për uljen e migrimit të parregullt. Pezullimi i bashkimeve familjare do të zgjasë të paktën dy vjet dhe do t'i prekë personat që nuk



kanë status të plotë të refugjatit. Dobrindt tha se ky vendim do të ndihmojë në "lehtësimin" e punës së këshillave lokalë, që janë të caktuar për të ofruar ndihmë dhe integrim të personave të sapoardhur në këtë shtet. Ai kujtoi se masa të

ngjashme ishin në fuqi mes vitit 2016 dhe 2018, në kohën kur Evropa u përball me krizën e migrantëve. Dobrindt, gjithashtu, njoftoi për heqjen e një reforme që ishte zbatuar nga qeveria paraprake, sipas së cilës, emigrantët mund

të aplikonin për shtetësi pas tre vjetësh qëndrimi në Gjermani nëse mund të dëshmonin se kishin pasur "sukses në integrim". Kërkesa për qëndrim tani do të rritet përsëri në pesë vjet. Sipas ministrit Dobrindt, masat e reja do të ndihmojnë në uljen e "faktorëve tërheqës" për migrantët që ndryshe mund të përpiqen të hyjnë në Gjermani në mënyrë të parregullt. Partia e ekstremit të djathtë, Alternativa për Gjermaninë (AfD), prej kohësh është kundër imigracionit, teksa figurat kryesore të partisë kërkojnë dëbime masive të të huajve. Merz është akuzuar nga kritikët se po përpiqet të fitojë mbështetje nga AfD-ja me retorikën e tij, por ai insiston se marrja e masave për migracionin është mënyra e

vetme për ta kundërshtuar rritjen e popullaritetit të së djathtës ekstreme. AfD-ja arriti rezultatin e saj më të mirë ndonjëherë, pak mbi 20 për qind, në zgjedhjet e përgjithshme të mbajtura në shkurt. Vendimet e së mërkurës pritet të miratohen nga Parlamenti para pushimeve të verës që fillojnë në korrik. Kontrollat më të ashpra në kufi, të paraqitura më herët këtë muaj, synojnë kthimin e të gjithë migrantëve të paligjshëm, përfshirë azilkërkuesit, dhe këto masa kanë irrituar disa nga fqinjët e Gjermanisë. "Nuk është habi që këto vendime kanë nxitur kritika", tha Dobrindt. "Por, ato janë të nevojshme për të treguar qartë se kemi ndryshuar kursin sa i përket migracionit".

Izraeli njofton për vendbanime të reja në Bregun Perëndimor

JERUSALEM, 29 MAJ - Izraeli njoftoi për krijimin e 22 vendbanimeve të reja në Bregun e pushtuar Perëndimor më 29 maj, duke rrezikuar përkeqësimin e mëtejshëm të raporteve me komunitetin ndërkombëtar, tashmë të tensionuara për shkak të luftës në Gazë. Ndërtimi i vendbanimeve izraelite në Bregun Perëndimor vazhdimisht dënohet nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, të cilat ajo i cilëson të paligjshme sipas të drejtës ndërkombëtare. Vendbanimet

shihen si një nga pengesat kryesore për paqe afatgjatë mes izraelitëve dhe palestinezëve. Vendimi për të ndërtuar vendbanime të reja, që është marrë gjatë mbledhjes së kabinetit për siguri të Izraelit, u bë publik nga ministri i Financave i ekstremit të djathtë, Bezalel Smotrich, i cili, po ashtu, është kolon, dhe nga ministri për Mbrojtje, Israel Katz, i cili është përgjegjës për menaxhimin e komuniteteve. "Kemi ndërmarrë një vendim historik për zhvillimin e

vendbanimeve: 22 komunitete të reja në Xhudea dhe Samaria, rinovimi i vendbanimit në veri të Samarias dhe përforcimi i boshtit lindor të shtetit të Izraelit", tha Smotrich përmes një postimi në X, duke përdorur termin izraelit për jugun dhe verin e Bregut Perëndimor, që Izraeli e ka pushtuar që ka nga viti 1967. "Hapi i radhës: sovraniteti", shtoi ai. Katz tha se nisma "ndryshon fytyrën e rajonit dhe formëson të ardhmen e vendbanimeve në vitet në vijim".



KUVENDI NUK KONSTITUOHET AS PAS TENTIMIT TË 23-të

Deputetët e Kuvendit të Kosovës regjistruan dështimin e 23-të. Ata u mblodhën të enjten rreth pesë minuta, por dështuan sërish ta formonin Komisionin Zgjedhor për Votim të Fshehtë për zgjedhjen e kryeparlamentarit. Për votuan 55 deputetë. Seanca e ardhshme do të mbahet të shtunën, më 31 maj, me fillim nga ora 10:30

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 29 MAJ - Deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë dështuar të enjten - për herë të 23-të radhazi - ta konstituojnë përbërjen e nëntë parlamentare, të dalë nga zgjedhjet e shkurtit. Dështimi për ta bërë Kuvendin e ri ka zhytur vendin në një ngërç politik duke e lënë atë edhe pa qeveri të re, kur kanë kaluar më shumë se tre muaj nga mbajtja e zgjedhjeve.

Dështimet e njëpasnjëshme po ndodhin pavarësisht prej thirrjeve nga brenda dhe jashtë vendit për të lëvizur përpara me krijimin e institucioneve. Të enjten ligjbërësit refuzuan për të trembëdhjetën herë rresht ta formonin një komision për mbikëqyrjen e një votimi të fshehtë për kreun e ri të organit ligjvënës.

Çështja e votimit të fshehtë që u propozua më 1 maj nga kryesuesi i seancës, Avni Dehari, pasi e propozuara e Lëvizjes Vetëvendosje (LV) për kryetare të Kuvendit, Albulena Haxhiu, nuk arriti në disa votime t'i merrte 61 votat e nevojshme për t'u konfirmuar në këtë post - është dërguar në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës nga partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë. Ato thonë se është jokushtetuese mënyra se si LV-ja po tenton që kryeparlamentari të votohet përmes formës së fshehtë, dhe i kanë kërkuar Kushtetueses të marrë "një masë të përkohshme për ndalim të mbajtjes së seancave, derisa me prioritet ta trajtojë këtë lëndë dhe ta marrë një vendim".

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Lista Serbe refuzuan sërish, në vazhdimin e seancës konstituive, të dielën, ta propozonin një përfaqësues që do ta siguronte mbarëvajtjen e votimit të fshehtë.

Seanca konstituive do të



vazhdojë të shtunën e 31 majit. Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, ka thënë pas kësaj seance se Lëvizja Vetëvendosje s'po bën "asnjë veprim" që do ta nxirrte Kosovën nga "situata e rëndë", duke insistuar në propozimin e Albulena Haxhiut pavarësisht se, siç tha, ka pasur të tjerë në LV që kanë pasur ambicie për t'u ulur në karrigen e kryetarit të Kuvendit.

Krasniqi ka thënë se bllokada po vazhdon edhe mbi tre muaj e gjysmë pas zgjedhjeve për shkak të kryeneçësisë politike të Albin Kurtit. "Ka kaluar një muaj e gjysmë prej kur ka filluar tentimi për ta konstituuar Kuvendin dhe mbi tre muaj e gjysmë prej kur janë mbajtur zgjedhjet, fatkeqësisht bllokada e iniciuar dhe e mundësuar nga Lëvizja Vetëvendosje po vazhdon në Kuvendin e Kosovës. Ne as sot s'kemi institucione dhe duket që s'ka as interesim e asnjë veprim që do ta nxirrte Kosovën nga situata e rëndë në të cilën kjo kryeneçësi politike e z. Kurti dhe partisë Vetëvendosje e ka futur vendin tonë. Vërtet është për keqardhje që s'ka asnjë reflektim", ka thënë Krasniqi.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka thënë se duhet bashkëbisedim për ta tejkaluar këtë situatë, kur është pyetur nga gazetarët para seancës nëse ka marrëveshje me Kurtin për postin e kryeparlamentarit. "Marrëveshjet politike ndërtohen ndryshe, nuk është çështje e befasive. Unë jam i gatshëm të takohem kurdo që kam ftesë. Kemi parë kafe me Glaukun para dy dite. Kemi biseduar. Është më se normale të bashkëbisedojmë për zhvillimet, shqetësimet dhe t'i trajtojmë temat si të dilet nga situata", ka thënë Limaj.

Deputeti i LV-së, Armend Muja, i akuzoi partitë që në legjislaturën e kaluar ishin në opozitë, për përpjekje për bllokimin e krijimit të qeverisë së re të udhëhequr nga Kurti: "Pra, qëllimet e PDK-së dhe të partive opozitare janë që të bllokohet konstituimi i Kuvendit dhe të parandalohet formimi i qeverisë Kurti", ka pohuar ai.

Deri më tani deputetët kanë kaluar vetëm dy pika të agjendës së seancës konstituive: raportin e Komisionit të

Përkohshëm për Verifikimin e Mandateve dhe atë të Betimit të Deputetëve.

Procesi ka ngecur te pika e tretë: te zgjedhja e kryeparlamentarit. Haxhiu e LV-së po konsiderohet figurë përçarëse nga dy parti parlamentare: PDK-ja dhe AAK-ja. Këto dy subjekte kanë kërkuar që LV-ja të propozojë emër tjetër për kryeparlamentar. LDK-ja, ndërkaq, ka thënë se nuk ka vota për asnjë të propozuar të LV-së për pozitën e kryeparlamentarit.

Propozimi për kryeparlamentar është e drejtë ekskluzive e fitueses së zgjedhjeve, LV-së, e cila ngul këmbë se Haxhiu meriton të zgjidhet dhe, ndonëse ka kërkuar marrëveshje politike me partitë e tjera, e ka përjashtuar mundësinë të sjellë kandidat tjetër pos saj.

Më 15 maj, pas një takimi të thirrur nga presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, me përfaqësues të partive politike, Osmani tha se nuk pati pajtim rreth konstituimit të Kuvendit, por shtoi se kishte parë një "disponim minimal" te liderët partiakë për të gjetur një zgjidhje për këtë çështje.

Deputetët duhet ta zgjedhin

kryetarin dhe pesë nënkryetarët për ta konstituuar përfundimisht Kuvendin e ri. Vetëm pas konstituimit të Kuvendit mund të formohet qeveria e re.

Kjo krizë vjen pasi asnjë parti nuk e fitoi shumicën për të qeverisur e vetme dhe ka mungesë të marrëveshjes mes tyre për të krijuar një shumicë të përbashkët.

Vetëvendosja doli e para duke i fituar 48 ulëse, 13 më pak se të paktën 61 të nevojshme për ta formuar qeverinë e re e vetme. PDK-ja zuri vendin e dytë me 24 ulëse, LDK e treta me 20, AAK-Nisma 8 dhe Lista Serbe 9.

Kurti tha më 20 maj se gjatë procesit të formimit të qeverisë do të jetë i gatshëm për kompromise dhe koncesione.

Kurti përmendi si partnerë të mundshëm pakicat, si dhe Nismën Socialdemokrate të Fatmir Limajt.

Të martën organizata të shoqërisë civile, përmes një performance, protestuan para Kuvendit në lidhje me moskonstituimin e institucionit ligjvënës. "Për çka ju kemi zgjedhë?", "Çdo vonesë ka kosto!" dhe "Çirku i demokracisë" ishin disa nga mesazhet e shkruara në fletë të bardha, të ngjitura në disa karrige të vendosura para hyrjes së Kuvendit të Kosovës.

Po ashtu, disa organizata të shoqërisë civile në vend u bënë thirrje partive "të arrijnë një marrëveshje që i jep fund bllokadës". Ato thanë se kriza institucionale me bllokimin e konstituimit të Kuvendit "ka kaluar çdo kufi të tolerueshëm dhe po dëmton jo vetëm Kuvendin, por edhe funksionimin e gjithë sistemit demokratik dhe institucional të vendit".

Javën e kaluar kryediplomatja e Bashkimit Evropian, Kaja Kallas, e cila vizitoi Prishtinën për herë të parë të enjten, u bëri thirrje partive parlamentare të bashkëpunojnë për ta zhblokuar ngërçin politik në vend.

Ambasada e Gjermanisë: Berlini mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, por nevojitet veprim

PRISHTINË, 29 MAJ - Ambasada e Gjermanisë në një postim në "Facebook" ka thënë se Berlini mbështet anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, por se për këtë gjë nevojitet veprim nga Qeveria e

Kosovës për zbatimin e zotimeve në dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Gjermania mbetet fort e përkushtuar që Kosova të anëtarësohet në Këshillin e

Evropës. Synimi është i arritshëm. Por, Kosovës i duhet të veprojë tani, përfshirë përmbushjen e zotimeve nën dialogun e lehtësuar nga BE-ja", ka shkruar Ambasada e Gjermanisë në Prishtinë.





BIZNESET BLOKUAN PËR DY ORË HYRJET E PRISHTINËS KUNDËR LIBERALIZIMIT TË TREGUT TË ENERGJISË

Përfaqësues të bizneseve kanë bllokuar të enjten hyrjet në kryeqytetin e Kosovës, në shenjë proteste për liberalizimin e tregut të energjisë, që do të nisë më 1 qershor. Vendimi i rregullatorit të energjisë përfshin kompanitë me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro. Në Kosovë janë të regjistruara mbi 1 000 kompani të tilla që konsumojnë rreth 37 % të energjisë së përgjithshme të shpenzuar. Përfaqësuesit e bizneseve thonë se janë kundër liberalizimit të tregut të energjisë, pasi nuk janë bërë përgatitjet e nevojshme për këtë ndryshim. Ata kërkojnë që ky vendim të shtyhet për një vit

bërë përgatitjet e nevojshme për këtë ndryshim. Ata kërkojnë që ky vendim të shtyhet për një vit. Drejtuesi i Odës Ekonomike, Lulzim Rafuna, tha gjatë protestës se bizneset po detyrohen të dalin në tregun e lirë dhe se ato do të përballen me një çmim të ri të rrymës, “220 deri në 270 për qind

tregun dhe bizneset. Çdo shtet ka një fazë tranzicioni, po ne nuk kemi”, tha Rafuna. Agim Shahini, kryetar i Aleancës Kosovare të Biznesit, tha se “bizneset nuk kanë dalë këtu për qejf, por sepse nuk mund ta përballojnë koston e energjisë elektrike”. “Askush nuk është

saj, duke thënë se ai mund të kontestohet vetëm përmes rrugëve ligjore. Në Kosovë liberalizimi i tregut të energjisë është paraparë me Ligjin për Energjinë Elektrike të miratuar në vitin 2016, por zbatimi i tij është shtyrë për shkak të rrethanave të ndryshme.

Kurti: Koha e barrikadave në Kosovë ka kaluar

Duke folur në një mbledhje të qeverisë në detyrë, Kurti tha se shtyrja e zbatimit të liberalizimit të tregut “nuk i zgjidh” problemet e bizneseve. “Oda Ekonomike e Kosovës, që do të duhej të qëndronte pranë bizneseve për t’u përballur me realitetin e ri, sot po tenton t’i bllokojë rrugët vetëm me një kërkesë - shtyrjen e zbatimit të liberalizimit të tregut. Shtyrjen po e kërkojnë me arsyetimin se do të përgatiten për një vit, duke injoruar faktin se nga ana e tyre nuk kanë bërë asnjë përgatitje për tetë vjetet e kaluara, përderisa shtyhej ky proces”, tha Kurti.

Kurti, duke iu drejtuar përfaqësuesve të bizneseve, tha se “ajo çfarë Oda Ekonomike e Kosovës nuk po u tregon se plotësimi i kërkesës së tyre nuk e zgjidh problemin, por veçse e bartin koston e energjisë të këtyre 1 200 ndërmarrjeve të faturat e secilit prej jush”. “Për t’i mbrojtur 1 për qind të ndërmarrjeve më të fuqishme në kurriz të 99-përqindëshit dhe familjeve të mbarë Kosovës, ata po duan të bëjnë barrikada në hyrjet e Prishtinës. Koha e barrikadave në Kosovë ka kaluar. I kemi hequr ato kudo”, shtoi ai.



më të lartë”. “Nuk ka qenë dëshirë jona të dalim të protestojmë sot. Kërkesa jonë është që institucionet të reflektojnë. Ne duam vetëm një fazë tranzicioni për të dalë në treg të lirë. Kemi kërkuar një vit për ta përgatitur

kundër tregut të lirë, por ky treg duhet të debatohet me sektorin privat. ZRRE-ja duhet ta rishikojë dhe ta kthejë vendimin, dhe t’i gjejmë mënyrat më të mira të mundshme për këto biznese, që janë fuqia më e madhe e vendit”, tha Shahini.

Shahini shtoi se ngritja e çmimit të energjisë për biznese “nënkupton ngritje të çmimeve të shërbimeve dhe të produkteve të ndryshme bazike”. Ai paralajmëroi se përfaqësuesit e bizneseve do të ndërmarrin “një hap tjetër, duke protestuar në mënyrë demokratike” javën e ardhshme.

Zyra e Rregullatorit për Energji tha për REL-in më 28 maj se nuk do të ketë shtyrje të afatit për liberalizimin e tregut të energjisë. ZRRE-ja qëndron pas vendimit të

PRISHTINË, 29 MAJ - Përfaqësues të bizneseve i bllokuan përkohësisht hyrjet në kryeqytet në shenjë proteste për liberalizimin e tregut të energjisë, për çka kryeministri në detyrë i Kosovës, Albin Kurti, e kritikoi Odën Ekonomike të vendit duke thënë se ajo “nuk ka bërë asgjë” për t’i përgatitur ato për këtë proces.

Mëngjesin e së enjtes ata i bllokuan për rreth dy orë hyrjet në Prishtinë, në Veterinik, te rrethi i flamurit, te qendra Dukagjini në rrugën drejt Fushë-Kosovës, në rrugën drejt Mitrovicës, si dhe në rrugën nga Podujeva, në lagjen e Vranjevcit.

Vendimi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) për liberalizimin e tregut të energjisë do të hyjë në fuqi më 1 qershor. Vendimi nënkupton se të gjitha bizneset e mëdha nuk do të furnizohen më me energji përmes tarifave të rregulluara, por duhet ta gjejnë vetë furnizuesin në tregun e lirë. Nëse nuk arrijnë ta bëjnë këtë, ato

kalojnë automatikisht në treg të hapur me çmime të parregulluara. Ky vendim përfshin kompanitë me mbi 50 të punësuar ose me qarkullim vjetor mbi 10 milionë euro. Në Kosovë janë të regjistruara mbi 1 000 kompani të tilla që konsumojnë rreth 37 % të energjisë së përgjithshme të shpenzuar.

Përfaqësuesit e bizneseve thonë se janë kundër liberalizimit të tregut të energjisë, pasi nuk janë



600 DITË LUFTË NË GAZË

Muhamet MAVRAJ

Nuk fitoi askush, por Gaza humbi gjithçka. Pra, nuk mjafton të kesh të drejtë. Duhet edhe vizion, edhe gjasa, edhe aleatë. Gaza, që ishte de facto shtet pas tërheqjes së Izraelit më 2005, nuk e kishte luksin të përzihej në gjeopolitikat e të mëdhenjve. Por, partia sunduese, Hamasi - si vegël e Iranit - u turr t'i dilte në ndihmë Rusisë për ta zhdukur Ukrainën nga faqet e ekranit. Me këtë zgjedhje, siç e thamë atëherë, këtu, pas 7 tetorit 2023, do ta zhdukte veten nga faqja e dheut. Trushpëlarja është taksirat. Tani faktet janë këto: Të gjithë 2.2 milionë banorët janë zhvendosur dhjetëra herë poshtë e lart nëpër gjerrmadha; Gaza e dikurshme - me 737 shkolla (për 625 mijë nxënës e 22 500 mësues), me 12 universitete (për 90 mijë studentë e mijëra profesorë), dhjetëra biblioteka, muze, arkiva, arkivi qendror - nuk ekziston më. Janë rrafshuar



spitalet, i tërë sistemi shëndetësor, ekonomia, monumentet (disa edhe mijëra vjeçare), ullishtat, fushat e

dredhëzave, shtëpitë, infrastruktura, fshatrat e qytetet. E kaluara dhe e ardhmja u shkatërruan.

E tërë kjo: nën liderë që së pari zhdukën opozitën dhe monopolizuan “patriotizmin”, bllokuan për 17 vjet zgjedhjet e

reja dhe e hodhën atdheun përballë qeverisë ultranacionaliste izraelite - më radikalja në historinë e tyre dhe superiore, aq sa përballë (Izraelit të vogël) 22 shtete arabe me 500 milionë arabë janë, thjesht, numra soditës, njësoj si edhe 35 shtete të tjera me shumicë islame, përfshirë Turqinë e hesapeve të veta. Deri tani ndëshkimi për mizoritë e një dite kryer nga Hamasi (7 tetor 2023) është: 50:1 të vrarë (mbi 55 mijë palestinezë për 1 139 hebrenj) dhe 100:1 me të plagosur dhe të zhdukur. Hamasi mban ende rreth 50 pengje - sa për t'u dhënë pretext bombardimeve të ardhshme. Liderët e tij dhe të Hezbollahut janë eliminuar. Grup pas grupi, 18 milicite e financuara nga Irani janë dërrmuar. Asadi, më në fund, kapitulloi dhe iku në Rusi. Në këtë luftë të ndyrë që e mbështeti civilizimin për muri, nuk fitoi askush. Por, Gaza humbi gjithçka. Me zgjedhje të gabuar vritet e ardhmja.



Furnizuesi i fundit: Zgjidhje e përkohshme

Aktualisht në treg janë të licencuara 21 kompani furnizuese me energji, ndërsa një tjetër është në proces licencimi. Shumica prej tyre janë nga Kosova, por ka edhe nga rajoni. Operatori për Furnizim me Energji, KESCO, që aktualisht furnizon shumicën e konsumatorëve familjarë dhe industrialë, është një prej tyre. Nëse një kompani nuk arrin të gjejë furnizues, ajo kalon automatikisht te Furnizuesi i Mundësisë së Fundit - aktualisht Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), e cila është zgjedhur përmes një tenderi të hapur nga ZRrE-ja. Nga ZRrE-ja thonë se nga 1 qershori bizneset që nuk e kanë zgjedhur kompaninë tregtare - automatikisht dalin në këtë furnizues. Ky furnizim nuk mund të zgjasë më shumë se 60 ditë dhe çmimet janë më të larta sesa çmimi mesatar i tregut. Nëse pas kësaj periudhe nuk lidhet kontratë me ndonjë kompani tregtare, biznesi rrezikon të mbetet pa furnizim me energji elektrike. Procesi i liberalizimit të tregut të

energjisë në vendet e Bashkimit Evropian ka filluar në fund të viteve '90 me qëllim rritjen e konkurrencës, efikasitetit, sigurisë dhe zgjedhjes për konsumatorët. Ndërsa në Ballkanin Perëndimor ky proces është ende në zhvillim e sipër.

Rizvanolli: Oda Ekonomike e Kosovës po ushtron presion ndaj bizneseve

Ministrja në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, në një konferencë për medie ka folur për protestën e sotme të bizneseve dhe vendimin e ZRrE-së për dalje në treg të hapur që prek rreth 1 200 biznese. “Ky proces është i përcaktuar me Ligj të Energjisë, i miratuar në vitin 2016. Kosova është vendi i fundit në rajon që po kalon në këtë tranzicion”, ka thënë Rizvanolli, duke shtuar se për të enjten kanë ftuar një takim me bizneset dhe kompanitë furnizuese, derisa tha “shpresoj që Oda Ekonomike e Kosovës ua ka përcjell ftesën bizneseve”. Ministrja në detyrë ngjashëm si kryeministri në detyrë, kritikoi Odën Ekonomike të Kosovës se ka nisur luftë politike. “Kemi dërguar ftesë që të kemi takim sot në orën

13:00. Bizneset kanë presion nga Oda Ekonomike e Kosovës për të mos marrë pjesë në takime, për të mos nënshkruar oferta me furnizues dhe për të dalë në protesta. Disa furnizues kanë thënë se hezitojnë të vijnë në takimin e sotëm për shkak se nuk ndihen mirë në një pozitë të tillë se disa biznese dhe oda i bëjnë të ndihen sikurse po e marrin njërën anë e jo atë të luftës politike që ka zgjedhur Oda Ekonomike e disa të tjerë”, tha Rivanolli.

Tregu i lirë energjetik, Krasniqi: PDK të premten do ta fillojë betejën ligjore, është krim kundër ekonomisë së Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Memli Krasniqi, pas dështimit të seancës konstituive për të 23-n herë, ka folur për protestën e bizneseve të Kosovës të cilat po kundërshtojnë tregun e lirë energjetik për shkak se ende nuk janë të përgatitura. Kreu i PDK-së tha se është për keqardhje që Kurti i krahason bizneset e Kosovës me bandat në veri për shkak të protestave e të barrikadave. “Me këtë rast PDK shpreh solidarizim me mbi 140 mijë punëtorë të mbi 1 000

bizneseve kosovare që sot në masë të madhe janë duke protestuar simbolikisht në rrugë magjistrale që e rrethojnë Prishtinën për t'u dëgjuar zëri i tyre që është injoruar nga qeveria”, tha ai. Sipas tij, vendimi që pritet të hyjë në fuqi më 1 qershor lidhur me liberalizimin e

me politikat e tij po i detyron sot të dalin në rrugë punëdhënësit e 143 mijë punëtorëve. “Nga 1 qershori, përmes një vendimi represiv, do të rritet çmimi i energjisë elektrike deri në 260 % për punëdhënësit më të mëdhenj në vend. Dy vjet nën sanksione



tregut të energjisë do të ketë pasoja që do ta paguajnë qytetarët e Kosovës.

Bajrami: Kurti me politikat e tij po i detyron të dalin në rrugë punëdhënësit e 143 mijë punëtorëve

Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, ka thënë se Albin Kurti

nga BE. Deficiti tregtar ka arritur rekord të paparë që nga paslufta. 100 mijë vende pune më pak, sipas të dhënave të vetë qeverisë. 2 123 kontrata njëburimore. Dhe tani: faturë energjie që rrezikon të mbyllë qindra biznese, në radhë të parë ato prodhuese! Kosova po shkon drejt rrënimit ekonomik, e qytetarët e saj drejt varfërisë. Kjo situatë është e padurueshme dhe e papranueshme. Këta rrënues duhet të ndalen bashkë me mafinë energjetike që po rrënon vendin. Verimi i ZRrE-së duhet të anulohet menjëherë”, ka theksuar Bajrami, duke shtuar se duhet të merren masat e nevojshme. “ZRrE, KOSTT, KEK, Ministria e Ekonomisë dhe të gjitha kompanitë private aktive në sektor duhet të auditohen dhe hetohen. Duhet punë konkrete për kapacitete gjeneruese”, ka deklaruar Bajrami.



KOMANDANT PASULI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Shpërfytyrim i një madhështie: E lavdishme Ushtria Çlirimtare e Kosovë doli nga populli që e donte lirinë pa pyetur për çmim që duhej paguar. Robëria e gjatë sidomos në shekullin e fundit, përveç mizorive të Jugosllavisë dhe Serbisë që kishte për synim shfarosjen e pjesës liridashëse të popullit shqiptarë, arriti që një pjesë jo të vogël të këtij populli ta bëjë për vete përmes beneficioneve të shumta deri në shkombëtarizimin e tyre duke u deklaruar si jugosllav dhe serbë. Pikërisht këta të shkombëtarizuar, duke i shërbyer qençe Jugosllavisë dhe Serbisë ushtruan dhunën më të madhe ndaj patriotëve të bindur shqiptarë. Ishin udbashë jugosllavë dhe serbë që flisnin shqip që torturuan deri në vdekje shumë ish të burgosur dhe ish të burgosura politike shqiptare. Masakrën në Drenicë pas kryengritjes kombëtare shqiptare e udhëhequr nga patriotët Shaban Polluzha dhe Mehmet Gradica e bënë partizanët e Fadil Hoxhës dhe Ali Shukrisë sikur edhe partizanët e Brigadës së Parë nga Shqipëria që udhëhiqej nga Shefqet Peqi. Masakrën e Tivarit e bënë partizanët serbë dhe malazias kurse partizanët e Shqipërisë nuk e penguan këtë. Patriotët nacionalist shqiptarë, Gjon Serreçi, Marie Shllaku, Ymer Berisha dhe të tjerët u morën në pyetje nga shqipfolësit, u torturuan nga ta dhe rekrutuan shumë dëshmitarë shqipfolës. Bacën Adem Demaçi fillimisht e denoncuan në UDB në Beograd sa ishte në studime, studentët shqipfolës të

rekrutuar nga UDB-ja. Pikërisht këta edhe dëshmuan kundër Bacës Adem për t'u bërë pastaj emra të shquar intelektualë dhe autoritete politike në Kosovë gjithnjë në shërbim të Jugosllavisë dhe Serbisë dhe kundër interesave kombëtare. Këta e mbytnën nën torturë Fazli Graçevcin, Shaban Shalën dhe shumë të tjerë. Këta ishin hetues, torturues, prokurorë dhe Gjykatës kundër patriotëve shqiptarë në procese politike e që pas përfundimit të luftës së dytë botërore njëjtësoheshin në personalitetin që i dha kuptim luftës për çlirim dhe bashkim kombëtar, të Papërsëritshmin dhe të Amshueshmin, Bacë Adem Demaçi. Ishte dhe mbeti Komandanti Politik i Shqiptarëve që lind një herë në 1000 vjet sikur që është edhe Komandanti Legjendar i të lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovë, Adem Jashari. Pikërisht të frymëzuar nga dy komandantët e shqiptarisë, që të dy sakrifikues që nuk njih bota, Baca Adem duke bërë 28 vite burg efektiv në llogoret e ish-Jugosllavisë sikur që pjesën tjetër të jetës e kaloi duke kundërshtuar robërinë ndërsa Legjendari Adem Jashari u sakrifikua personalisht, bashkë me familjen që i kishte edhe bashkëluftëtarë, shumë të rinj dhe të reja iu shkuan pas në rrugëtimin e gjatë dhe të rrezikshëm për liri dhe bashkim kombëtar gjatë aktiviteteve ilegale dhe legale, nëpër burgje dhe llogore sikur edhe në luftën çlirimtare të UÇK-së. Aty, shumë prej tyre e fituan lavdinë dhe

pavdekësinë. Kishte ushtarë dhe ushtarë në moshë fare të njomë, që luftës iu bashkuan nga bankat shkollore.

Çfarë ndodhi pastaj: Nuk thuhet kot se luftën e bëjnë idealistët kurse pushtetin e marrin, në shumë raste maskarenjtë dhe horrat. As Kosova nuk bënë përjashtim. Pjella e ish udbashëve u bë pjesë e Policisë së Kosovës, mendësia jugosllave dhe serbe, tash të mbështjellur me një patriotizëm shqiptar kapi mediet, diplomacinë, shoqërinë civile dhe u metastazuan në të gjitha segmentet e shoqërisë si këshilltarë, anëtarë të ekipeve negociatore duke ndikuar në shumë procese vendimmarrëse, në dëm të Kosovës dhe çështjes kombëtare. Mendermethënë Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës u dominua në shumicën e kohës nga të rekrutuar të mëhershëm nga UDB-ja, madje në krye të saj ishte edhe një i rekrutuar nga KOS - Shërbimi Kundërzbulues Usharak i Jugosllavisë përgjegjës për vrasje të shumë ushtarëve shqiptarë dhe kurdisje të shumë proceseve politike para gjykatave ushtarake ku janë dënuar me qindra e qindra ushtarë shqiptarë. Nëse e analizojmë, qoftë edhe sipërfaqësisht përbërjen e qeverisë Kurthi 1 dhe 2 e sidomos Listën e deputetëve në dy mandatet e fundit ku ka dominuar LV-ja, atëherë lehtësisht bindeni se as në kohën e Rrahman Morinës nuk ka pasur më shumë

antikombëtarë. Disa që kanë pasur të kaluar kombëtare mbresëlënëse, janë zbutur me poste dhe favore kurse disa nuk pyeten as sa kushton “pazari i qenve”. Disa që patriotizmin e kanë të trashëguar, janë bërë më të këqij se ata që gjë nuk kanë bërë për këtë vend duke e përloçur dhe turpëruar këtë trashëgimi. Madje, duke keqpërdorur këtë trashëgimi janë bërë grabitqarë të posteve dhe përfitues të pamerituar dhe të paskrupullt të të mirave materiale. Hajdutë dhe keqbërës ordinerë.

Një ish-udhëheqës jugosllav, Millovan Gjillas, pastaj i shndërruar në disident, e pati lënë një thënie antologjike që nuk e luan as topi: “vllast je najveća stras..”, në shqip: “pushteti është pasioni më i madh ..”. Pushteti ka koritur dhe shpërfytyruar politikanë dhe burra me histori të lavdishme dhe lëre më këta adoleshentët politikë të LV-së që asgjë nuk kanë bërë për këtë vend përveç që i marrin çdo gjë duke e vjedhur pamëshirshëm nën mbrojtje të Kupolës së Hekurt të Albin Babës. Në kohën kur para një Gjykate Speciale Raciste po gjykohet Ushtria e Lavdishme Çlirimtare e Kosovës dhe po bëhen përpjekje për kriminalizim të një luftës çlirimtare me qëllim të fundit të rishkrimit të historisë kombëtare, nuk më habit aspak fakti se pushteti e pret me padurim dënimin e udhëheqësve të luftës dhe paqes, të krijuesve të shtetit dhe shpallësve të pavarësisë, konsolidimit të shtetit përmes 120 njohjeve ndërkombëtare,

ndërtimit të infrastrukturës rrugore më të mirën në Ballkan dhe shumë të arritura tjera sa më habit fakti se një numër i tyre që kanë bërë luftë të lavdishme, me shumë sukses, sot janë bërë zëdhënës të atyre që e duan dënimin e çlirimtarëve, dërgojnë dëshmi që i marrin nga Serbia, përgatisin dëshmitarë të rrejshëm, pakësojnë fondet për mbrojtje dhe kërkojnë që ata të mos kthehen në Kosovë sepse mund ta eskalojnë situatën. A shihni këtu ndonjë dallim nga kërkesat e Serbisë?! Ministri i FSK-së sot, dikur ushtar i guximshëm i UÇK-së sot është shndërruar në një propagandues të paskrupullt të pushtetit, në vend të përkrahë pengjet e Hagës, ua rëndon situatën. Rrenë botërisht se: “letra e Hashim Thaçit dërguar KFOR-it, na pamundëson ta dërgojmë FSK-në, në veri të Kosovës..”. E kanë zënë në rrenë në Bullgari, në Amerikë, ka kaluar kufijtë e Kosovës për këtë aktivitet. Tash, nga një komandant i UÇK-së, është shndërruar në Komandant Pasuli, dikur shpërndante plumba kundër ushtarëve, policëve dhe paramilitarëve të Serbisë, tash po shpërndanë pordhë të Albin Kurthit kundër atyre që e sollën lirinë dhe e ndërtuan shtetin e që pushteti me padurim po pret të dënohen nga Gjykata Raciste Speciale. Nuk e di të ketë mallkim më të madh të historisë dhe përfundim më të turpshëm se kur nga një ushtar shëmbullor i Komandantit Legjendar Adem Jashari të përfundosh si rrogëtar i nënshtruar i “komandantes” Dejona Mihali!

Gjermania konfirmon mbështetjen për FSK-në

PRISHTINË, 29 MAJ - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerallejtënant Bashkim Jashari, me nderime të larta ushtarake ka pritur në vizitë zyrtare shefin e Mbrojtjes së Gjermanisë, gjeneralin Carsten Breuer. Gjatë takimit të përbashkët, komandanti i FSK-së i uroi mirëseardhje gjeneralit Breuerit dhe e njoftoi për zhvillimet dhe të arriturat e fundit të Forcës së Sigurisë së Kosovës, duke theksuar fushat

e bashkëpunimit bilateral dhe aktivitetet e përbashkëta. Gjenerali Breuer e përgëzoi gjeneral Jasharin për sukseset dhe profesionalizmin e treguar nga FSK-ja, duke vlerësuar rolin e saj në garantimin e një mjedisi të sigurt dhe të qëndrueshëm, njëkohësisht ofroi vazhdimin e mbështetjes së forcave gjermane për FSK-në në përputhje me objektivat e saj. Në fokus të bisedës ishte edhe thellimi i bashkëpunimit konkret në fusha kyçe të

sigurisë dhe mbrojtjes, duke përfshirë arsimimin dhe trajnimin e pjesëtarëve të FSK-së në institucionet ushtarake gjermane, si dhe organizimin e trajnimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta në të ardhmen. Gjithashtu, u diskutua situata aktuale e sigurisë në Kosovë dhe në rajon, duke ndarë mendime dhe vlerësime mbi rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për ruajtjen e stabilitetit dhe paqes afatgjatë në Ballkanin Perëndimor dhe më gjerë.



Vizita e gjeneralit Breuer paraqet një moment të rëndësishëm për FSK-në, duke përfunduar partneritetin

strategjik me Gjermaninë dhe mbështetjen e saj për zhvillimin e mëtejshëm të Forcës sonë.

DY VJET NGA DHUNA NË ZVEÇAN, MË SHUMË SE 90 USHTARË TË KFOR-IT ISHIN LËNDUAR

PRISHTINË, 29 MAJ - Teksa Policia e Kosovës thotë se situata aktuale në veri të vendit, dy vjet pas dhunës mes serbëve lokalë dhe pjesëtarëve të KFOR-it është “e qetë, por delikate”, dhe se “shumëçka ka ndryshuar për mirë”, banorët serbë të kësaj zone thonë se situata nuk ka qenë kurrë më keq. Personat me të cilët bisedoi Radio Evropa e Lirë e përshkruan jetën e tyre pas majit të vitit 2023 krejt të ndryshme, duke e cilësuar atë muaj si “pikë kthese”, kur nisi mbyllja e institucioneve që funksiononin sipas sistemit të Serbisë në Kosovë. Më 29 maj 2023 në Zveçan ndodhi një përleshje e dhunshme mes protestuesve serbë dhe trupave të misionit paqeruajtës të NATO-s në Kosovë, KFOR. Protesta ishte thirrur kundër hyrjes së kryetarit shqiptar në ndërtesën e komunës, pasi serbët i kishin bojkotuar zgjedhjet lokale me thirrje të Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve të Kosovës që gëzon mbështetjen e Beogradit. Si rezultat, në krye të komunave me shumicë serbe në veri - Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zveçan dhe Zubin Potok - erdhën kryetarë shqiptarë. Nga përplasjet në Zveçan mbetën të plagosur rëndë dhe lehtë 93 ushtarë të KFOR-it që ishin të dislokuar para ndërtesës së komunës. Ndërkohë, u lënduan



edhe rreth 50 serbë, shumë prej të cilëve më pas u larguan në Serbi dhe aktualisht nuk janë të qasshëm për drejtësinë në Kosovë. KFOR-i e cilësoi sulmin ndaj pjesëtarëve të tij si “të paprovokuar dhe plotësisht të papranueshëm”, duke kërkuar që të gjithë pjesëmarrësit në dhunë të “ndiqen urgjentisht penalisht”. Kymision ndërkombëtar shprehu gjithashtu shpresën se edhe autoritetet në Serbi po hetojnë personat që u kthyen atje pas trazirave.

Radio Evropa e Lirë ka kërkuar informata nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe Prokuroria për numrin e personave të ndjekur penalisht deri tani dhe për ndonjë proces në vazhdim lidhur me sulmin ndaj KFOR-it, por nuk ka marrë përgjigje. Përgjigje për këtë çështje nuk dha as Prokuroria e Lartë Publike në Beograd. Ajo që dihet publikisht në Kosovë është se më shumë se dhjetë persona janë arrestuar në lidhje me dhunën në Zveçan. Disa janë dënuar me rreth një vit burg, pas marrëveshjeve me prokurorinë

për pranimin e fajësisë. Meqenëse u është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim, këta persona tashmë janë në liri, ndërsa të tjerë janë mbrojtur në gjendje të lirë. Nga ana tjetër ende nuk dihet nëse drejtësia serbe ka hapur apo po zhvillon ndonjë hetim për rastin e sulmit ndaj KFOR-it. Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës për rajonin e veriut, Veton Elshani, në një deklaratë për Radion Evropa e Lirë kujton se më 29 maj të vitit 2023 në Zveçan ndodhi, siç e përshkruan

ai, një “luftë e vogël”. Por, sipas tij, sot situata është “krejtësisht ndryshe”. “Gjendja është ende delikate për shkak të aspektit politik, por është e qetë”, thotë Elshani. Ai thekson se Policia e Kosovës tani ka “kontroll të plotë” mbi sigurinë në veri dhe se nuk ka më “grupe të armatosura” që punojnë për destabilizim. Më 29 maj 2023 në turmën e protestuesve serbë kishte edhe persona me maska të cilët u përfshin në përleshje me ushtarët e KFOR-it duke përdorur shok-bomba, koktej molotovi dhe mjete të tjera të forta. Këto trazira u shndërruan në pikënisjen e tensioneve të reja në veri të Kosovës, që kulmuan në shtator 2023 kur një grup i serbëve të armatosur sulmoi Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë pranë Zveçanit. Në atë sulm u vra rreshteri i policisë, Afrim Bunjaku, ndërsa gjatë shkëmbimit të zjarrit mbetën të vrarë edhe tre sulmues serbë. “Nuk ka më grupe të armatosura në Kosovë. Sa i përket veriut të Kosovës, mund të themi se është i sigurt. Situata ka ndryshuar shumë”, thotë Elshani. Ai shton se Policia e Kosovës është në kontakt të përhershëm me KFOR-in për çështjet që lidhen me veriun dhe se bashkërisht organizojnë patrullime ose shkëmbejnë informacione të rëndësishme.

Shpallen zgjedhjet për anëtarët e Këshillit Drejtues të UP-së

PRISHTINË, 29 MAJ - Senati i Universitetit të Prishtinës ka shpallur zgjedhjet për anëtarët e UP-së në Këshillin Drejtues. Në mbledhje u vendos të shpallen zgjedhjet për pesë anëtarët nga personeli akademik që përfaqësojnë Universitetin e Prishtinës në Këshillin Drejtues. Senatorët, pa vota kundër dhe abstenime, miratuan shpalljen e konkursit dhe përcaktimet e kriterëve për përzgjedhjen e studentëve të rinj në programet baçelor dhe master. U aprovua njëzëri edhe Rregullorja për Zyrën e Ombudspersonit, pasi

me statutin e ri të korrikut të vitit 2024, UP-ja duhet të ketë një avokat për studentë. Ndryshim i vogël iu bë tekstit të rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm. Termi “bashkëpunëtorë të jashtëm” u zëvendësua me “profesorë të angazhuar”. Senati vendosi të shpallë thirrje publike për profesorë dhe asistentë të angazhuar dhe ua vazhdoi angazhimin kësaj kategorie në UP për vitin 2025/’26. Në mbledhje u përcaktuan qartë edhe kriteret dhe dallimet

mes konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare. Në Senat kaluan njëzëri edhe disa tema doktorate nga njësitë e ndryshme akademike të UP-së, sipas rekomandimeve të Këshillit Qendror të Studimeve të Doktoratës, derisa u diskutua edhe rreth shfrytëzimit të hapësirave universitare nga palët e treta. U vendos që palët e treta që nuk kanë mision të njëjtë a të ngjashëm me Universitetin e Prishtinës nuk mund t’i shfrytëzojnë hapësirat e këtij universiteti.



Rizvanolli thotë se diskutimet për tregun e hapur të energjisë vazhdojnë

PRISHTINË, 29 MAJ - Prodhuesit vendorë dhe odat ekonomike janë mbledhur në takim në radhës për t'iu ofruar bizneseve informatat dhe mjetet që u duhen për t'u përballur me tregun e liberalizuar.

Ministria në detyrë e Ekonomisë, Artane Rizvanolli,

ka thënë se në këtë takim Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRE) raportoi se gjashtë furnizues janë aktivë dhe pesë tashmë kanë dhënë oferta për biznese. Ndërsa, sipas saj, interesimi i kompanive rajonale është rritur dhe numri i licencave për furnizim ka shkuar në 21. “SharrCem”, i

cili operon në treg të hapur që nga viti 2017, ndan përvojën e tyre të vyeshme. Korporata Energjetike e Kosovës sqaroi mundësinë ligjore të ‘furnizuesit të mundësisë së fundit’ për ata që ende nuk kanë kontratë. Ne si qeveri do të vazhdojmë t’u qëndrojmë afër bizneseve dhe t’i

përkrahim në mënyrë praktike, me qëllim që bizneset të marrin vendime të informuara dhe të mos mbesin të pambrojtura. Takimi i radhës do të jetë me furnizuesit, për të nxitur transparencë dhe kushte të favorshme për të gjithë”, ka njoftuar Rizvanolli.



QEVERIA NË DETYRË EMËRON DISA DREJTORË TË RINJ DHE MIRATON VENDIME PËR PROJEKTE KAPITALE

PRISHTINË, 29 MAJ - Qeveria në detyrë e Kosovës ka mbajtur mbledhje në të cilën ka emëruar Fikrije Zymberi në pozitën e drejtoreshës ekzekutive në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur; Besa Bytyqi - Baraliu në pozitën e drejtores së Përgjithshme të Inspektoratit të Arsimit; Sebahate Bushrani - Ibraimi në pozitën e drejtores ekzekutive në Agjencinë e Meteorologjisë së Kosovës. Gjithashtu, qeveria ka emëruar edhe Komisionin Ad hoc për Vlerësimin Profesional për Pranim në pozitën e lartë të Kategorisë Drejtuese: drejtor ekzekutiv në Thesarin e Kosovës.



Po ashtu, qeveria ka ndarë 20 721 euro me qëllim mbulimin e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale të Nismës

Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjatë (MARRI); ka emëruar Komisionin e Ankesave për Shtetësi. Ky komision do të funksionojë si organ i pavarur administrativ për shqyrtimin e ankesave ndaj vendimeve për

shtetësinë, duke siguruar një proces të drejtë dhe transparent. Qëllimi është forcimi i mbrojtjes së të drejtave të qytetarëve dhe përmirësimi i procedurave administrative në këtë fushë. Kabineti qeveritar ka miratuar vendimin preliminar për shpronësim për interes publik të pronave të paluajtshme të cilat preken nga realizimi i projektit Mbyllja e Deponisë aktuale dhe realizimi i Deponisë Sanitare të Re në Pejë, Zona Kadastrale Lutogllavë, komuna e Pejës; ka emëruar Labinot Zeqiri në pozitën e kryeinspektorit të Inspektoratit Qendror të Shëndetësisë; ka plotësuar dhe ndryshuar tabelat nga paragrafi 2 i nenit 10 të Ligjit nr. 02/L-128 për Barnat Narkotike, Substancat Psikotrope dhe Prekursorë, duke u bazuar në

mekanizmat për ndërrim dhe plotësim të përcaktuar me Konventat Ndërkombëtare për kontrollin e Narkotikëve; ka rialokuar 4.5 milionë euro në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal nga projekti kapital “Bashkëfinancimi me donatorët për skemën e granteve bazuar në performancën komunale” në 25 projekte kapitale në përputhje me 25 marrëveshjet e mirëkuptimit për projekte kapitale të nënshkruara nga ministri i MAPL-së dhe kryetarët e komunave dhe donatorët; ka aprovuar Planin e rishikuar të Veprimit 2025-2026 për zbatimin e Strategjisë për Vetëqeverisje Lokale 2016-2026. Përmes këtij plani të veprimit synohet të rritet autonomia lokale dhe të ofrohen shërbime me kosto efektive nëpër komuna.

ÇMIMET E IMPORTIT NË KOSOVË SHËNOJNË RRRITJE TË LEHTË NË TREMUJORIN E PARË TË KËTIJ VITI

PRISHTINË, 29 MAJ - Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksën e Çmimeve të Importit (IÇIMP) për tremujorin e parë (TM1) 2025, viti bazë 2010=100.

Indeksi i tërësishëm i çmimeve të importit në Kosovë është i njëjtë me 0,1 % në TM1 2025 krahasuar me TM4 2024.

Në TM1 2024 çmimet e importit patën një rënie në një mesatare prej (-1,9 %).

Ngritje më të mëdha të çmimeve sipas sektorëve ishin te: shtazët e gjalla, produktet e shtazëve (6,8 %); produktet bimore (2,7 %); lëkura dhe artikujt e saj (1,6 %); produktet

minerale (0,7 %); artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit (0,6 %); pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike (0,3 %); dhe plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre (0,2 %).

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorit te: artikujt e ndryshëm të prodhuar (-4,1 %); vajrat ushqyese (-3,1 %); metalet bazë dhe artikujt e metaleve bazë (-2,2 %); instrumentet optike, fotografike, matëse, medicinale, muzikore dhe mekanizmat e orës (-1,4 %); mjetet e transportit (-0,4 %); produktet e industrive kimike (-0,3 %); letra



dhe artikujt e saj (-0,2 %); druri dhe artikujt e tij (-0,1 %); dhe artikujt ushqimorë të përgatitur,

pijet dhe duhani (-0,1 %). Çmimet e Importit në Kosovë patën një rënie në një mesatare

prej (-1,9 %) ndërmjet TM1 2025 dhe TM1 2024. Ngritje më të mëdha sipas sektorëve ishin te: produktet bimore (4,2 %); shtazët e gjalla dhe produktet e shtazëve (1,2 %); tekstili dhe artikujt e tekstilit (1,1 %); druri dhe artikujt e tij (0,9 %) etj.

Ngritja u neutralizua kryesisht nga rënia e çmimeve sipas sektorëve: lëkura dhe artikujt e saj (-23,6 %); artikujt e ndryshëm të prodhuar (-8,4 %); produktet minerale (-8,1 %); instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore dhe muzikore dhe mekanizmat e orës (-6,6 %); vajrat ushqyese (-6,2 %) etj.

BERZh: Shqipëria t'i ndryshojë politikat industriale

TIRANË, 29 MAJ - Për zhvillimin e industrisë tradicionale në orientimin drejt teknologjisë dhe inovacionit, Shqipëria do të fokusohet në riformulimin e politikave për këtë sektorë.

Banka e Shqipërisë në konferencën e përbashkët me BERZh dha disa sugjerime për qeverinë, ndërsa e cilësoi të rëndësishme kualifikimin e fuqisë punëtore. “Këto

shërbime të inovacionit global’ si teknologjia e informacionit, dizajni, logjistika dhe analiza e të dhënave janë në zemër të rritjes së produktivitetit dhe vlerës së shtuar, por për t’i zhvilluar, nevojiten themele të forta: investime në arsim, fuqi punëtore e kualifikuar, infrastrukturë digjitale moderne dhe kapacitete të larta institucionale”, u shpreh Sejko.

Për ta rritur konkurrueshmërinë në tregun evropian, BERZh-i pritë ta ndihmojë Shqipërinë në disa sektorë të rëndësishëm. “Strategjia gjithashtu synon ta ndihmojë sektorin privat shqiptar që të përgatitet për qasje në tregun e përbashkët evropian. Kjo do të arrihet përmes rritjes së financimit direkt dhe indirekt, përmirësimit të konkurrueshmërisë dhe

integritimit të bizneseve shqiptare në zinxhirët globalë të vlerës. Financimi do të shoqërohet me asistencë teknike të shënjestruar për rritjen e produktivitetit dhe nxitjen e inovacionit”, u shpreh Ekaterina Solovova, drejtuese e zyrës së BERZh në Shqipëri. Në konferencë u paraqit edhe raporti i tranzicionit i BERZh-it për vitet 2024-2025, ku fokusi



kryesor do të jenë investimet në energji të gjelbër, por dhe fuqia punëtore.

SI I IKU TRISHTIMI TOLSTOIT

Nga: Fabio Molina ACOSTA
Përkthet: Bajram Karabolli

Ky njeri nuk është endacak, as lypës, as i varfër. Është Leon Tolstoi [Leo Tolstoy], gjeniu i letërsisë ruse. Në moshën 50-vjeçare, Tolstoi ra në një depresion të thellë. Pavarësisht famës, pasurisë dhe fisnikërisë së tij – ishte një kont dhe i njohur në të gjithë botën – ai ndjeu një zbrazëti që asgjë nuk mund ta mbushte. Zbuloi se paratë, pushteti, madje edhe shëndeti nuk ishin garanci për lumturinë. Njohu njerëz të pasur të pakënaqur dhe njerëz të sëmurë që donin të jetonin. Dhe, në mes të gjithë kësaj, po thahej brenda. Një ditë, duke ecur përgjatë rrugës “Afanasevsky”, ai pa një fëmijë jetim. Iu dhimb shumë dhe e çoi në shtëpi. Ky veprim,

diçka ndryshoi. Për herë të parë pas një kohe të gjatë, ndërkohë që mendonte për dikë tjetër përveç vetes, trishtimi iu shua dhe u ndje i gjallë. Që nga ajo ditë, ai braktisi luksin dhe privilegjet, u vesh me rroba të thjeshta dhe ia kushtoi jetën të tjerëve. “Mos më fol për fenë apo bamirësinë, më trego me veprimet e tua”, thoshte ai. Ai predikoi jo dhunën, mbrojti vëllezërinë midis popujve dhe idetë e tij frymëzuan Gandin. Shumë e quanin të çmendur. Por në një botë të fiksuar që të kesh sa më shumë, Tolstoi zgjodhi të jepte. Një mik i vjetër e pyeti një herë: “Pse i bën të gjitha këto? Pse të intereson dikush tjetër?” Dhe Tolstoi u përgjigj me një frazë të pavdekshme: “Nëse ndjen dhimbje, je i gjallë, por nëse ndjen dhimbjen e të tjerëve, atëherë je me të vërtetë njerëzor.”



PËRDITËSIM PËR MENDJET

Nga: Aurel PLASARI

Të paktën ka, në botën që na rrethon, njerëz që mendojnë, që i kuptojnë të vërtetat, por edhe i thonë. Ndjek hera-herës njërin prej tyre, Alexis Haupt. Sikur libri i tij “Fjalim mbi robërinë intelektuale: nga nënshtrimi intelektual te mohimi i tiranisë” të lexohej sa më shumë, diçka do të përmirësohej në të kuptuarit e botës. Alexis Haupt është i datëlindjes 1990, pra nuk ka pasur nevojë të kalojë nëpër totalitarizëm, si puna e brezit tonë, për t’ia dalluar atij simptomat dhe për të menduar në mënyrë të kthjellët. Pikërisht prandaj kam përshtypjen që libri tij, sikur edhe me titullin, ia bën me sy një libri tjetër, një traktati klasik të mendimit çlirues njerëzor: “Fjalim mbi robërinë vullnetare”, të botuar në latinisht më 1574, më pas në frëngjisht më 1576, me autor një Etienne de la Boétie (1530-1563). Vitet 1574 dhe 1576 janë të botimit, por llogaritet që autori ta ketë shkruar këtë traktat në moshën 18 vjeç, në mos edhe më herët. Të tillë, gati çunak, e ka përjetësuar edhe shtatorja e ngritur për të në komunën Sarlat-la-Kaneda, Dorgonjë, Francë. La Boétie-a në shek. XVI argu-




mentonte se çdo tiran mban pushtet për sa kohë që nënshtetasit e tij ia lejojnë. Lirinë origjinale ia ka dhënë njeriut natyra, sipas tij. Por, shoqëria njerëzore, duke u korruptuar nga zakoni, e braktis dhe pëlqen më shumë robërinë e kurtizanit sesa gjendjen e njeriut të lirë që nuk pranon të nënshtrohet e të bindet. Kjo, e thjeshtuar kështu, mund të quhet teza themelore e traktatit. Ja një formulim, tanimë klasik, prej tij: “Do të doja vetëm të kuptoja se

përse kaq shumë njerëz, kaq shumë fshatra dhe qytete, ndonjëherë kaq shumë kombe, durojnë një tiran që nuk ka asnjë forcë përveç asaj që i është dhënë, që nuk ka asnjë pushtet për të bërë dëm përveç atij që i është toleruar. Ku mund të gjejë ai qaq shumë sy për të të spiunuar po të mos ia kesh huazuar ti? Si mund të ketë ai qaq shumë duar për të të kapur po të mos i ketë marrë prej teje? Jini pra të vendosur për të mos shërbyer më dhe do të jini të lirë!”

Si tezë që trajton marrëdhëniet mes dominimit dhe bindjes, teza e La Boétie-së është rimarrë nga dhjetëra mendimtarë të mëpasëm. Siç është përdorur prej tyre, edhe është shpërdorur nga ndonjë shkollë, ajo e anarkistëve fjala vjen. Teza e tij ka rezultuar e parapëlqyer sidomos nga lëvizjet e “mosbindjes civile”, të cilat nxorën nga koncepti i rebelimit kundër “robërisë vullnetare” bazën e instrumentit të tyre të betejës. Étienne de La Boétie llogaritet edhe njëri ndër

të parët që ka propozuar “mosbashkëpunimin” si formë të mosbindjes jo të dhunshme, por si armë efektive kundër një pushteti robërues. Ç’është më interesantja, La Boétie-a ka refuzuar trajtimin e atyre që i ka quajtur “përbetime njerëzish ambiciozë”, të interesuar vetëm për rrëzimin e një kurore, por jo për largimin e një mbretërimi, ose për dëbimin e despotit, por për mbajtjen gjallë të tiranisë. Teza e tij synon, në parim, ndryshim dhe çlirim të thellë nga pushteti i shndërruar në sundim. Por, po kthehem tek Alexis Haupt dhe libri i tij, të cilin e rekomandoj për lexim: “Fjalim mbi robërinë intelektuale: nga nënshtrimi intelektual te mohimi i tiranisë” mund të lexohet edhe duke e blerë online në formatin Kindle (2,99 €). Them se të gjithëve na bën mirë pak update-ing mendor. “Totalitarizmi sot, – thotë Alexis Haupt, – nuk është më një burrë me mustaqe që ulërin para një mikrofonit, as Gulagu, por është kodi QR, injeksioni i detyruar i një produkti në gjak, monedha digjitale, çimka në krah ... Dhe medet, në kohë e sipër sa qeniet njerëzore të përditësojnë softuerin e tyre dhe ta kuptojnë, tiranët çirakë e kanë rrugën të shtruar”.



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Zhegrova, afër transferimit te Napoli

Ylli nga Kosova, Edon Zhegrova, pritet të bëhet transferimi i parë i kampionit të Italisë, Napolit, në afatin kalimtar të verës. Shuma e

transferimit të tij nga Lille pritet ta kapë shifrën e 25 milionë eurove. 26-vjeçari ka qenë nën vëzhgim të veçantë nga klubi italian për një kohë

të gjatë. Siç raporton “Radio Kiss Kiss” e Napolit, futbollisti i është rrëfyer një menaxheri në një restorant italian. Sipas stacionit

radiofonik, Zhegrova thuhet se ka thënë: “Jam një hap larg Napolit. Agjentët e mi po zgjidhin detajet e fundit”. Përpos Zhegrovës, Napoli

është afër marrëveshjes për transferimin e Kevin De Bryune, mesfushorit belg që do të largohet nga Manchester City si lojtar i lirë.

Prishtina dhe Drita vazhdojnë me risi, Dukagjini ‘blindon’ Munishin

Klubet elitare vazhdojnë të jenë aktive. Prishtina ka vazhduar kontratat me dy futbollistë, Ardian Limanin dhe Ramiz Bytyqin, Drita ka ndarë rrugët me portierin Florian Smakiqi, ndërsa Dukagjini ka “blinduar” trajnerin Ismet Munishi

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 MAJ - Fituesja e Kupës së Kosovës në futboll, FC Prishtina, ka vazhduar kontratat me futbollistët Ardian Limani dhe Ramiz Bytyqi. Limani edhe pse kishte oferta të tjera nga klube të ndryshme, ka vendosur t’i mbetet besnik klubit kryeqytetas. “Futbollisti i palodhur dhe me përvojë është i njohur për angazhimin e tij në çdo pozitë që kërkohet. Ai do të vazhdojë të kontribuojë edhe më tej në projektin e Prishtinës. Ardian Limani ka rinovuar me klubin për dy vjet të tjera pavarësisht interesimit nga klube të tjera”, thuhet në njoftimin e Prishtinës.

Limani, i cili në të kaluarën ishte pjesë e Dritës dhe Feronikelit, pjesë e Prishtinës është nga janari i vitit 2024. Për dy vjet kontratën me Prishtinën e ka vazhduar edhe Ramiz Bytyqi. “Ramiz Bytyqi do të jetë pjesë e FC Prishtina edhe për dy vitet e ardhshme. Vrapues i pandalshëm dhe gjithmonë i gatshëm për të kontribuar në mbrojtje dhe në sulm. Ky vazhdim kontrate është dëshmi e besimit të ndërsjellë mes lojtarit dhe klubit për objektiva të mëdha në të ardhmen”, ka njoftuar klubi prishtinas. Të mërkurën kontratën e ka vazhduar me skuadrën fituese të



Kupës edhe Ardian Muja si dhe portieri Agron Kolaj. Portieri Florian Smakiqi është larguar nga skuadra kampione e Superligës, Drita. Lajmi është dhënë në llogarinë zyrtare të klubit nga Gjilani në rrjete sociale. “Pas përfundimit të kontratës Smaki ka vendosur që karrierën ta vazhdojë diku tjetër, vendim të cilin klubi e ka respektuar dhe në ndeshjen e fundit është përshëndetur me bashkëlojtarët dhe tifozët”, thuhet në njoftimin e Dritës. Smakiqi te Drita ishte transferuar si lojtar i lirë në vitin 2022 nga skuadra e Drenicës. Ai më parë kishte luajtur edhe për Feronikelin dhe Prishtinën. E skuadra e Dukagjinit nga Klina ia ka besuar shtabin teknik edhe për edicionin e ardhshëm 2025/2026, trajnerit aktual Ismet Munishi. Klubi nga Rrafshi i Dukagjinit është i

lumtur që ka arritur marrëveshje të re me trajnerin Munishi, dhe beson se kjo marrëveshje do t’i sjellë stabilitet edhe më të madh klubit. “Me shumë kënaqësi njoftojmë opinionin publik dhe tifozët se po vazhdojmë bashkëpunimin me kryetrajnerin Ismet Munishi edhe për një sezon tjetër. Jemi të lumtur që puna dhe përkushtimi i Munishit do të jenë sërish pjesë e projektit tonë për sezonin e ardhshëm. Besojmë se vazhdimësia dhe stabiliteti që sjell kjo marrëveshje janë themel i rëndësishëm për suksesin që synojmë. KF Dukagjini falënderon Munishin për besimin dhe angazhimin dhe i uron gjithë të mirat në vazhdim”, thuhet në njoftimin e këtij klubi. Dukagjini kampionatin e përfundoi në pozitën e shtatë me 48 pikë.

SHKURT

Kayserispori interesohet për Hoxhën

Arbër Hoxha mund të transferohet te Kayserispori gjatë merkatos së verës. Klubi turk është duke shqyrtuar seriozisht mundësinë për ta transferuar anësin shqiptar. Trajneri aktual i Kayserisporit, Sergej Jakiroviq, e njëj mirë Hoxhën pasi kanë punuar së bashku te Dinamo Zagrebi, ku trajneri kroat pati një ndikim të madh në zhvillimin e tij. Jakiroviq e sheh lojtarin si pjesë kyçe në ndërtimin e një skuadre më konkurruese për sezonin e ardhshëm. Sipas “Transfermarkt”, vlera e Hoxhës në treg është rreth 1.5 milion euro. Një shifër e arsyeshme për Kayserisporin, që po kërkon përforcime cilësore pa kosto të lartë. Për momentin, bisedimet janë në fazë paraprake, por nëse palët arrijnë marrëveshje, Hoxha pritet të ribashkohet me ish-trajnerin e tij në Turqi, në një projekt të ri te Kayserispori.

Klinikë ndërkombëtare për trajnerët e gjeneratave të reja me trajnerin Arik Shivek

Federata e Basketbollit e Kosovës ka njoftuar se nga data 4 deri më 7 shtator 2025 do të organizojë Klinikën Ndërkombëtare për trajnerët që punojnë me gjeneratat e reja, me fokus të veçantë në zhvillimin e lojtarëve U14. Kjo klinikë do të udhëhiqet nga eksperti ndërkombëtar Arik Shivek, një trajner i njohur me përvojë të gjatë në basketbollin evropian dhe zhvillimin e talentëve të rinj. Aktiviteti do të mbahet në Prishtinë dhe synon të ofrojë përmbajtje praktike dhe teorike për trajnerët vendorë që janë të përkushtuar për ndërtimin e brezit të ardhshëm të lojtarëve. Federata e Basketbollit e Kosovës shpreh mirënjohje të veçantë për FIBA dhe Olympic Solidarity dhe Komitetin Olimpik të Kosovës për mbështetjen e vazhdueshme dhe përkrahjen konkrete për realizimin e kësaj iniciative.

Çeku: Kurrë më parë nuk është investuar kaq shumë në infrastrukturën e futbollit

PRISHTINË, 29 MAJ - Ministri në detyrë i Ministrisë për Kulturë, Rinë dhe Sport, Hajrulla Çeku, ka thënë se në infrastrukturën e futbollit po punohet dhe investohet si asnjëherë më parë deri më tani. Çeku në “Facebook” ka shkruar se me këto investime, po ndërtohet një infrastrukturë moderne e cila u shërben brezave të rinj, klubeve vendore, përfaqësueses sonë dhe ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare, si Lojërat Mesdhetare “Prishtina 2030”. “Asnjëherë më parë nuk është investuar kaq shumë dhe

kaq seriozisht në infrastrukturën e futbollit në vendin tonë. Po ndërtojmë infrastrukturë moderne që u shërben brezave të rinj, klubeve vendore, përfaqësueses sonë dhe ngjarjeve të mëdha ndërkombëtare, si Lojërat Mesdhetare “Prishtina 2030”, ka shkruar Çeku. Stadiumet e përfunduar dhe në realizim: Stadiumi “Fadil Vokrri” në Prishtinë, stadiumi “Liman Gegaj” në Malishevë, stadiumi “Adem Jashari” në Mitrovicë, stadiumi i qytetit në Shtime, stadiumi i qytetit në Gjakovë,

stadiumi i Gjilanit, stadiumi i Hogoshtit në Kamenicë, stadiumet ndihmëse në Komoran në Bërnice, Gjilan, Raushiq dhe Studençan. Në procedurë: stadiumi “Shahin Haxhiislami” në Pejë, stadiumi i qytetit në Ferizaj, stadiumi “Përparim Thaçi” në Prizren, stadiumi i qytetit në Rahovec, stadiumi “Ferki Aliu” në Vushtrri, stadiumi “Rexhep Rexhepi” në Drenas, stadiumi i qytetit në Suharekë, stadiumi i qytetit në Han të Elezit, stadiumi “Zahir Pajaziti” në Podujevë.



Oklahoma shpallet kampione në Konferencën e Perëndimit, rikthehet në finalët e NBA-s pas 13 vjetësh

OKLAHOMA, 29 MAJ - Skuadra e Oklahoma City Thunderit është shpallur kampione në Konferencën e Perëndimit, pasi arriti të triumfojë në finalen e pestë ndaj Minesotës me shifrat 124-94 duke fituar 4-1 serinë e ndeshjeve. Një rikthim pas 13 vitesh i Oklahoma në

finalët e NBA-s (viti 2012 hera e fundit), ku pret ta mësojë emrin e ekipit rival, që do të dalë nga përballja mes Indianas e New Yorkut në Lindje. Më 5 qershor do të luhet finalja e parë. Triumf i merituar për Oklahoman në Perëndim, skuadra me

rezultatit më të mirë në sezonin e rregullt dhe që do të ketë në favor faktorin fushë. Kjo do ta ndihmojë për titullin e parë kampion në NBA. Ndeshja e luajtur të mërkurën në mbrëmje nuk pati histori, me Oklahoman ndjeshëm më superiore në parket, ku u dallua

i zakonshmi Alexander Shai, autor i 34 pikëve. Randle realizoi 24 pikë për Minnesotan, por që mbetën për statistikë. Gjithsesi duhet thënë se edhe rrugëtimi deri në finale të Konferencës së Perëndimit ishte një sukses për Timberwolves, që arriti ta



eliminonjë edhe një prek ekipeve pretendente këtë sezon, siç ishte Los Angeles Lakers.

Tifozët e Realit kërkojnë rikthimin e Ronaldos, Al Nassri pret rinovimin e kontratës

MADRID, 29 MAJ - Tifozët e Real Madridit kanë befasuar me banerin e ri të cilin e shfaqën sot. Përballë qendrës stërvitore “Valdebebas” u pa një baner në të cilin shkruante: “Florentino, riktheje Cristianon!”. Tifozët madrilenë po duan që presidenti Florentino Perez ta rikthejë veteranin e sulmit, të paktën për Botërorin e Klubeve, i cili do të mbahet nga 15 qershori deri më 13 korrik. Në javët në vazhdim “CR7”-shit do t'i skadojë kontrata me Al Nassrin dhe postimi i tij i fundit për mbylljen e një kapitulli la të kuptohet se 40-vjeçari e ka mbyllur aventurën në Arabinë Saudite. Prandaj edhe tifozët e “Los Blancos” kërkojnë nga krerët e klubit që ta rikthejnë Ronaldon, të cilin duan ta shohin të luajë përsëri për Real Madridin, së paku në Botërorin e Klubeve, i cili do të mbahet në Shtetet e Bashkuara të Amerikës këtë verë.



Ish-futbollisti i Sporting Lisbonës, Manchester Unitedit dhe Juventusit ka lënë gjurmë në Madrid dhe tifozët e këtij klubi nuk do ta harrojnë kurrë kontributin e tij. Në anën tjetër, klubi saudit Al Nassr shpreson që Ronaldo ta vazhdojë kontratën. “Jemi në kontakt për ta rinovuar kontratën e Cristiano Ronaldos dhe ne me të vërtetë shpresojmë

që ai të vazhdojë me ne këtu në Al Nassr. Prania e Ronaldos që në fillim është projekt kombëtar. ‘CR7’ është një fenomen i madh në historinë e futbollit. Ai e ndihmoi Ligën Saudite të rritet. Çdo ditë në medie shfaqet një klub i ri i interesuar për Ronaldon, por ne shpresojmë që ai të qëndrojë këtu”, thuhet në reagimin e Al Nassrit.

Maresca: Jemi gati për Ligën e Kampionëve

LONDËR, 29 MAJ - “Një gëzim i madh”, u shpreh Enzo Maresca me medaljen e artë në qafë dhe pas ngritjes në qiell të trofeut të Ligën e Konferencës, të fituar ndaj Betisit. Rezultati përfundimtar 4-1 erdhi me përmbysje spektakolare, teksa Chelsea u gjet në disavantazh që në minutën e 9 të ndeshjes. Skuadra londineze u përqendrua dhe në pjesën e dytë të finales realizoi “poker”, që i siguroi klubit rekordin e të gjithë trofeve të mundshëm të UEFA-s. Në intervistën pas ndeshjes për “Sky Sport”, trajneri Maresca deklaroi: “Vuajtëm pak në pjesën e parë, por më pas ndryshuam diçka dhe gjithçka shkoi më mirë. Jemi të lumtur, sepse mbyllëm një sezon të madh. Edhe në Premierë Ligë arritëm ta siguronim Ligën e Kampionëve me një skuadër shumë të re,



kështu që jemi vërtet të kënaqur”. “Pak a shumë e prisja këtë. Ne kishim 48 orë më pak kohë për rikuperim. Ata (Betis) luajtën të premtën dhe nuk kishin objektiva. Ne luajtëm të dielën dhe 100 minuta për një synim të rëndësishëm deri në sekondën e fundit. E dija që mund ta fillonim pak dobët, por ndryshuam diçka taktike në fund

të pjesës së parë. Mesazhi ishte që spanjollët po jepnin diçka më shumë se ne”, ka shtuar ai. I pyetur se a është Chelsea gati për Ligën e Kampionëve, Maresca është përgjigjur: “Po, jemi gati. E mbyllëm mirë kampionatin. Tani kemi një javë, rreth dhjetë ditë pushim, pastaj do të shkojmë në Amerikë (për Kupën e Botës për Klube)”.

SHKURT

Sassuolo synon rikthimin e Bajramit

Sezoni që sapo u mbyll nuk ishte nga më pozitivët për mesfushorin e Shqipërisë, Nedim Bajrami që me Rangers në Skoci, arriti të shënojë vetëm dy herë si dhe të dhurojë pesë asistime. Edhe pse Bajrami është ende nën kontratë me gjigandët skocezë, e ardhmja e tij mbetet ende në pikëpyetje, kjo pasi sikundër bënë me dije e përditshmja italiane “La Gazzetta dello Sport”, ish-skuadra e tij Sassuolo e rikthyer këtë sezon në elitën e futbollit italian është e interesuar për Bajramin. Thuhet se klubi italian ka përgatitur edhe ofertën drejtuar Ranger, rreth 2.1 milionë euro për ta riblerë kartonin e tij, një vlerë kjo që vështirë se do të pranohet nga klubi skocez, që shpenzuan gushtin e 2024-s, rreth 3.5 milionë euro për ta shpëputur nga klubi Emilian. Kujtojmë që Nedim Bajrami ka luajtur për Sassuolon për 3 sezone, përpara se të transferohej në Skoci te Rangersi.

Verstappeni: Në Spanjë synoj fitoren ashtu si në Imola

“Arritja në garën e Barcelonës, që zhvillohet këtë fundjavë, me një deficit prej 25 pikësh ishte qëllimi ynë”. Është kjo deklarata e dhënë sot nga katër herë kampioni i botës në Formula 1, Max Verstappen. “Monaco nuk ishte gara jonë. Ne bëmë gjithçka mirë, por në fund nuk mundëm të bënim më shumë pas rezultatit të arritur në kualifikueset”, ka deklaruar Verstappen. “Në Spanjë presim një performancë më të mirë, më afër asaj në Imola ku dhe fituam. Mendoj se duhet të jemi më komodë dhe për këtë arsye më konkurrues. Pista ka kthesa të gjata dhe kthesa me shpejtësi të lartë dhe është gjithmonë bukur të pilotosh aty. Në Barcelonë fitova garën time të parë në Formula 1. Shpresoj ta shpreh versionin më të mirë të kësaj jave”, ka shtuar ai. Verstappen ka fituar tre edicionet e fundit në pistën e Montmelo dhe këtë fundjavë ai do të synojë një “poker” në karrierë në pistën spanjolle.

Jonathan Tah nënshkruan kontratë katërvjeçare me Bayernin

Bayern Munichu ka zyrtarizuar transferimin e qendërmbrojtësit gjerman Jonathan Tah. Mbrojtësi 29-vjeçar u bashkohet bavarezëve si transferim i lirë nga Bayer Leverkuseni dhe ka nënshkruar kontratë deri më 30 qershor 2029. Tah do ta mbajë fanellën me numrin 4 te Bayerni, duke shtuar përvojë dhe stabilitet në qendër të mbrojtjes së kampionëve gjermanë. I lindur në Hamburg, Tah e nisi karrierën në akademinë e Hamburger SV në vitin 2009. Ai debutoi për ekipin e parë në vitin 2013 në moshën 17-vjeçare, duke u bërë lojtari më i ri që luante për klubin në atë kohë. Reprezentuesi gjerman është shprehur shumë i lumtur që do të jetë pjesë e skuadrës më të madhe në Gjermani. “Jam shumë i lumtur që jam te FC Bayern. Dua të marr përgjegjësi këtu dhe të punoj shumë çdo ditë në mënyrë që të kemi sukses si ekip dhe të fitojmë shumë trofe së bashku”, ka thënë Tah gjatë prezantimit të tij në “Allianz Arena”.

Portieri i Arsenalit fiton trofeun ‘Doreza e Artë’ në Premierë Ligë


Portieri i Arsenalit, David Raya, fitoi për të dytin vit me radhë trofeun “Doreza e Artë” në Premierë Ligë. Një çmim që i jepet portierit më të mirë. Raya konkurronte për këtë çmim bashkë me Matz Sels të

Nottingham Forest, pasi që të dy kishin mbajtur portën të paprekur në 13 ndeshje, por ajo që vendosi emrin e fituesit ishte numri më i paktë i golave që pësoi Arsenali në kampionat, 34 gola karshi 46 golave të pësuar

nga Forest. “Çdo çmim është i veçantë, por mënyra se si u mbrojtëm këtë sezon ishte fantastike. Patëm shumë lëndime dhe shpesh në mbrojtje luanin lojtarë të ndryshëm”, ka thënë Raya. “Kjo

tregon gatishmërinë për të vazhduar të bësh gjërat e duhura dhe merita shkon për të gjithë ata që ndihmuan ekipin të qëndrojë pretendent deri në fund”, ka shtuar portieri spanjoll. “Është një moment i

veçantë. Të bësh diçka të tillë në këtë klub të mrekullueshëm dhe të vendosësh diçka në historinë e klubit, është e pabesueshme. Jam shumë krenar që e kam arritur këtë”, ka deklaruar Raya.



Lume's Details

Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë-Ministraskoo Pravde-Ministry of Justice

Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar
Agencija za Upravljanje Zoplenjenom i Konfiskovanom Imovinom
Agency for Administration of Sequestered and Confiscated Assets



AAPSK
AGENCIJA PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SË SEKUESTRUAR DHE TË KONFISKUAR

Ftesë për Ankand Publik

Datë 28.05.2025 **Referenca: AAPSK – 009/2025**

AAPSK- njofton të gjithë të interesuarit se ofron për shitje mallin si në vijim, sipas lëndës së paraqitura më poshtë:

Nr	Përshkrimi	Sasia/copë	Çmimi Fillestar/ copë	Çmimi nga ofertuesi	Çmimi total €
1	Seat Ibiza, viti i prodhimit 2009, dizel ngjyre e hirit- me targa vendore-Rishpallje	1 copë	3,150.00€		
2	Daimler Benz 124, viti i prodhimit 1985, dizel, ngjyrë hiri metalike-me targa vendore	1 copë	900.00€		
3	Daimler Chrysler 210 E 200 CDI Klasik,automatik,dizel, viti i prodhimit 1999, ngjyrë e kaltër e mbylltë metalike-me targa vendore	1 copë	2,000.00€		
4	Passat 3C, viti i prodhimit 2005, dizel, automatik,, ngjyrë e zezë metalike- me targa vendore	1 copë	4,700.00€		
5	VW Golf V,viti i prodhimit 2004, dizel ngjyre e hirit metalike-me targa vendore	1 copë	4,800.00€		
6	VW Golf II,viti i prodhimit 1991, ngjyrë vishnje- për skrap	1 copë/ për skrap	213.44€		
7	VW Caddy, viti i prodhimit 2005, dizel ngjyre e kuqe -me targa vendore	1 copë	2,000.00€		

Oferta e nënshkruar, vulosur dhe e mbyllur në zarf duhet të dorëzohet më së largu deri m.04.06.2025 në ora 11:00h, në lokalet e AAPSK-së, në adresën: Depo e Agjencisë Rr. Bajram Bahtiri (ish Kazerma e FSK-se) fshati Llukar KK Prishtinë.

Të interesuarit mallin mund ta shikojnë me datë: 04.06.2025, prej orës 10:00-11:00 në Depon e Agjencisë në fshatin Llukar KK Prishtinë,

Pasurit e sekuestruar ose te konfiskuara ne këtë procedure shitje procedohen për shitje, me çmimin e lartë cekur në gjendjen siç janë. Të drejtë pjesëmarrjeje kanë të gjithë personat fizik dhe juridik. Personat juridik të cilët marrin pjesë duhet që me veti të sjellin Certifikatën e regjistrimit të biznesit, kurse personat fizik kopjen e letërnjoftimit personal. Fitues do të jetë oferta e ofruar me çmimin më të lartë. Të interesuarit mund të tërheqin dokumentacionin e ankandit-listën e artikujve në zyrën nr. 1012, prej orës 08:00-16:00, ose mund të shkarkohen në web faqen e AAPSK-se në: <https://aapsk.rks-gov.net> apo <https://md.rks-gov.net/>.

Në zarf të shkruhet për: AAPSK, Divizioni i Shitjes; oferta mos të hapet para orës 11:00.Adresa: Ministria e Drejtësisë, Agjencia për Administrimin e Pasurisë së Sekuestruar dhe të Konfiskuar Ish Pallati i Rilindjes, kati 10, Divizioni i Shitjes nr. 1012, Prishtinë, tel 038 200 67 254



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Cjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook  www.facebook.com/gjeipuneshpeite

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Aurora Tarakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. dhe tri dëftesat të vitit të I,II,III të shkollës “Gjon Buzuku” Prizren.

- Sabina Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 1.2.3.4 dhe diplomën e shm Mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.

- Dion Zeqa shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10të shkollës së mesme të muzikës “Prenk Jakova” Gjakovë.

- Ema Kaja shpall të pavlefshme dëftesën e shfmu “Mazllum Këpuska” Gjakovë nga kl. 6-9.

- Suela Jakupi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të shfmu “Yll Morina” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Vlora Deva shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 diploën dhe testin e maturës të gjimnazit “Hajdar Dushi” Gajkovë.

- Dialon Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Kongresi i Manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Nexhat Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë shfmu “Kongresi Manastirit” Damjan Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.

- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

- Lëshoj banesë me qira, pent-house. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1900

Columbus, Georgia, USA
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

